



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**M E S A Z H
I
DREJTORIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT,
z. HELIDON BENDO**

Të nderuar punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit,

Me dekretin nr.10937, datë 05.11.2018, Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta, më ka besuar drejtimin e Shërbimit Informativ të Shtetit. Propozimi i Kryeministrit dhe vendimi i Presidentit të Republikës më ngarkojnë me përgjegjësinë e lartë për të udhëhequr Shërbimin Informativ të Shtetit, si një institucion kyç për garantimin e sigurisë kombëtare.

SHISH-i ndër vite ka dhënë një kontribut të çmuar si organ informativ në çështjet e sigurisë kombëtare. Autoritetet më të larta shtetërore dhe organizatat e partnerët ndërkombëtarë e kanë çmuar rolin themelor parashikues, parandalues dhe goditës të SHISH-it.

Të nderuar kolegë,

Gjithçka e arritur dhe e ndërtuar nga SHISH-i është fryt i përpjekjeve tona të përbashkëta dhe i rolit të qindra punonjësve të ndershëm e profesionistëve të vërtetë të inteligjencës, me të cilët kemi bashkëpunuar e bashkëpunojmë ndër vite. Ndaj sot vlerësoj se është momenti, që bazuar te parimet bazë të punës sonë, si LIGJSHMERIA, OBJEKTIVITETI dhe SEKRETI, të angazhohemi për të çuar cilësisht përpara punën dhe produktin e Shërbimit Informativ të Shtetit.

Me këtë rast, më lejoni të përçoj te çdo punonjës i Shërbimit vlerësimin dhe mbështetjen e Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Duke mirëpritur kontributin tuaj, ju uroj punë të mbarë.

DREJTORI

Helidon Bendo